



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 92, datë 28.04.2022

MBI

**MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “BROKAS SECURITIES”
SH.A. ME KËRKESAT E LIGJIT NR. 62/2020 “PËR TREGJET E KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, pikës 1, të nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, si dhe nenit 12 dhe pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 24, të Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Ligji nr.62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” në nenin 377, pika 1, parashikon se: “Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, shoqëria “Brokas Securities” sh.a., duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Shoqëria “Brokas Securities” sh.a. mban licencën nr. 20 datë 27.02.2020 si shoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në “Bursën Shqiptare të Titujve ALSE”.

Licenca që mban shoqëria “Brokas Securities” sh.a si shoqëri brokerimi nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara është e njëjtë me shërbimet e investimit si: marrje dhe transmetim urdhërash të klientit, ekzekutim urdhërash, të përcaktuara në Ligjin e ri 62/2020.

Shoqëria “Brokas Securities” sh.a ka depozituar në Autoritet një raport të detajuar të përshtatshmërisë me kërkesat e Ligjit 62/2020 dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në përputhje me Rregulloren nr. 195, datë 29.12.2020.

Në përmbushje të këtyre kërkesave, shoqëria “Brokas Securities” sh.a ka:

- Përditësuar statutin;
- Përputhur strukturën organizative me kërkesat e nenit 39 të Ligjit nr. 62/2020;
- Certifikuar, sipas vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, funksionarët kryesorë dhe brokeri;
- Depozituar rregullat, dhe procedurat në përputhje me kërkesat e Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë komisionere “Brokas Securities” sh.a me kërkesat e Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij për:**

Ofrimin e shërbimeve të investimit:

- a) Marrje dhe transmetim i urdhrave;
- b) Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve.

Në instrumentet financiare si më poshtë:

- a) Titujt e transferueshëm;
- b) Instrumentet e tregut të parasë.

- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE